



Përse hesht Ministri i Mjedisit?

Para disa ditësh revista "MAPO" botoi një fakt tronditës: Gruaja dhe vajza e Xhuvelit zotërojnë një fabrikë për veshjen e gomave në Fier, e cila s'ka punuar asnjë ditë për riveshje por vetëm ka tregtuar goma të përdorura. Këtë fakt e nxjerr në dritë dhe një deputet i "Partisë Agrare Ambientaliste", Nikolla Neranxi. Në deklarimin e pasurisë së vetë, Ministri Xhuveli nuk e përmend këtë pasuri të familjes së tij. Fabrika e veshjes së gomave gjithmonë ka qenë një problem i madh mjedisor dhe korrupsioni.

Në të gjithë Europën nuk lejohet me ligj të rivishen gomat e përdorura. Ato hyjnë në mbeturinat e rrezikshme dhe duhen eliminuar në kushte të sigurt. Nga djegia e tyre çlirohen shumë kimikate të rrezikshme, dy nga të cilat, dioksina dhe furanet, janë nga më vdekjeprurëset. Për këtë arsye, Komiteti i Mjedisit dhe Ministria e Shëndetësisë, morën në vitin 1993 ligjin "Për ndalimin e importit të gomave të përdorura me qëllim riveshjeje". Kjo u bë edhe nga fakti që në këto vite kishte shumë presione nga biznesmenë të huaj për të hapur një fabrikë riveshjeje.

Sic tregon sot Lirim Selfo, ish Kryetar i Komitetit të Mjedisit në ato vite: "Në atë kohë ne na erdhi dhe një këshillim nga Green Peace, i cili na shpjegonte se kompanitë mafioze sillnin fabrikën e veshjes së gomave vetëm për të justifikuar importin e gomave nga vendet perëndimore dhe fabrika nuk vijej kurrë në punë, ndërkohë që importimi vazhonte të mbushte vendin me mbeturinat e rrezikshme të Europës". E njëjta taktikë si me plehrat e Kasharit. Por në vitin 1997, disa "biznesmenë" arritën të "influencojnë" deri në Këshillin e Ministrave dhe ky ligj u anulua nga një vendim që lejonte importimin e gomave me qëllim riveshjeje. Në vitin 1999 përsëri Këshilli i Ministrave rikthen ligjin "për ndalimin e importimit të gomave të përdorura". Por po brenda vitit 1999 përsëri RM nxjerr vendimin për importimin e tyre.

Sipas deputetit Neranxi, Xhuveli ka qenë gjithmonë brenda kësaj loje korruptive dhe shpesh ideatori i saj. Fabrika e gnas dhe bijës së tij, e cila s'ka punuar asnjëherë, e forcoi në shumë këtë thënie të tij. Edo fakti që tregon z. Neranxi se, kur Xhuvelit iu premtua posti i Ministrit të Mjedisit, ai dante t'ia kalonte fabrikën Neranxit për ta marrë në përdorim (por që ky s'e pranoi) vërteton qartë konfliktin e Ministrit të ardhshëm "të mjedisit", i cili duhet t'i japë leje mjedisore gnas së tij për të rrotur mjedisin me kimikate vdekjeprurëse. Pas gjithë këtyre fakteve ai vazhdon të mos dalë në publik dhe të sqarojë çështjen.

Por Ministri i Mjedisit duhet të dalë në publik edhe për një fakt tjetër të ri që përsëri lidhet me mjedisin. Në konfliktin e fundit të peshkatarëve të Shkodrës me sipërmarrësin e Dajlanit në ishullin në hyrje të liqenit, doli se ky ishull i qenka shitur një privati. Ligji mjedisor e thotë qartë se nuk lejohet të shiten pasuritë kombëtare ujore siç është ishulli i liqenit të Shkodrës. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit(?) të Ujërrave e ka ndjekur problemin e konfliktit të peshkatarëve nëpërmjet inspektorëve të saj, e di shumë mirë që ishulli është shitur me dokumente të rregullta dhe përsëri Ministri Xhuveli hesht. Por hesh-tja e tij, sot kur media dhe qop qytetar është i lirë të gjejë dhe tregojë të vërtetën, i ngjan veprimi të strucit. Xhuveli mund ta fus kokën në mjedisin e rrotur (që ka krijuar) të krijuar prej tij, por Mjedisi real shihet qartë nga të gjithë.

Xhuveli në konflikt interesi

I jep leje mjedisi vajzës së vet për gomat e përdorura Ministri i mjedisit fshihet mediave



Xhuveli me fabrikë gomash të përdorura


Konflikti i peshkatarëve zbulon një pronar të ishullit

Sa zona të tjera të mbrojtura janë shitur?

Kanë ushtruar aktivitetin e peshkimit në ishullin e Dajlanit për plot 30 vjet

Tashtë peshkatarët kërcënojnë se do të hidhen në grevë urie, nëse bashkiakët i ndalojnë që të peshkojnë...

Lexo fq. 3



Ishulli që është shitur

Është më mirë të debatosh një çështje pa e zgjidhur sesa ta zgjidhësh pa e debatuar.

Josef Joubert

Zv/ministri i mjedisit premtan që do takojë 28 shoqatat mjedisore "Ekolëvizja"



Pas katër muajsh ministria e mjedisit ka reaguar pozitivisht ndaj kërkesës për takim të 28 shoqatave të grupimit "Ekolëvizja".

Zv/ministri i Mjedisit Taulant Bino ka premtuar për të diskutuar mbi urat e bashkëpunimit ndërmjet shoqatave mjedisore dhe Ministrisë si dhe në lidhje me organizimin e transparencës së informacionit dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje të theksuara nga konventa e Aarhusit.

Konventa e Aarhusit veç të tjerash në nenin 6 kërkon që:

• palët të garantojnë pjesëmarrje të publikut në marrjen e vendimeve me një ndikim të rëndësishëm të mundshëm mbi mjedisin.

• autoritetet publike t'i japin publikut të interesuar për mundësi informimi të gjithë informacionin lidhur me marrjen e vendimeve.

Lexo fq. 3

Zogu që kushton 5000 EURO

Lexo fq. 7



Biznesi kanceroz i ministrit Lufter Xhuveli

Shqiptarët e njohin si ministrin më jetëgjatë dhe në fjalëpakë, por në të vërtetë, emri i drejtuesit të dikasterit të Mjedisit, z. Lufter Xhuveli, duhet të hyjë në histori si emri i ndotësit më të madh të mjedisit në Shqipëri.

Lexo fq. 4

Korrupsioni në mbrojtjen e mjedisit

Metamorfoza për ligjin e gomave të përdorura tregon se ka raste që shteti i kën ligjet nisur nga interesat e përfitimeve personale të një individi apo grup individësh ndërsa ato publikohen si ligje për të mirën e tërë shoqërisë.

Lexo fq. 2

Guidat natyrore në Velipojë



Lexo fq. 7

Guidë turistike nënujore në Vlorë



Lexo fq. 7



Ngjarje nga vendi

KESH-i drejt privatizimit

Ministria e Energjetikës i ofron Moskës privatizimin e korporatës në këmbim të "Gazprom"-it.

Hidhen hapat e para për privatizimin e Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare. Ky është rezultati i takimit të përfaqësuesve të dy ministrive përkatëse në Moskë. Pasi ka bërë vlerësimet përkatëse Ministria e Energjetikës ka zgjedhur që ofertën për shitjen e kësaj Korporate t'ia paraqesë homologëve Ruse të Energjetikës.



të hidrokarbureve "Gazprom" në Shqipëri, duke i prezantuar si këmbim planet për privatizimin e KESH-it. Sipas burimeve zyrtare nga Ministria jonë e Energjetikës, pala ruse i paraqiti asaj shqiptare një memorandum konkret bashkëpunimi në fushën elektroenergjetike. KESH-i mori përsipër të infomojë palën ruse për të gjitha projektet e reja apo rehabilituese, si dhe për të gjitha hapat në kuadër të privatizimit të tij të ardhshëm.

Në këtë mënyrë nga kjo marrëveshje do të përfitohet nga njëra anë privatizimi i korporatës dhe nga ana tjetër kalimi transit i gazit rus përmes Shqipërisë. Bisedimet rreth kësaj marrëveshjeje janë zhvilluar në 8-11 tetor, në Moskë gjatë sessionit të katërt të bashkëpunimit ekonomik dhe shkencor midis dy vendeve.

Pala shqiptare kërkoi që gjigandi rus "Gazprom" të shpërtojë të gjitha projektet për të parë mundësinë e bashkëpunimit Shqipërisë për të qenë e pranishme

GAZPROM në Shqipëri
Zv. ministri i Ekonomisë, Eno Bozbo, që kryesonte delegacioni shqiptar u ka kërkuar homologëve rusë, shtrirjen e kompanisë ruse

në territorin e vendit tonë. Sipas njoftimit për shtyp të Ministrisë së Energjetikës, një kërkesë e tillë u mirëkuptua nga pala ruse, duke theksuar se përfaqësuesi i "Gazprom"-it shprehur angazhimin e kompanisë së tij për të ndërmarrë hapa konkretë.

Kjo kërkesë u sanksionua në protokollin e marrëveshjes, të firmosur nga të dy kryetarët, në të cilën thuhet se "pala shqiptare i paraqiti palës ruse interesin e vendit të saj për furnizimin me gaz natyror nëpërmjet kompanisë ruse "Gazprom" dhe ndërtimin e gazsjellësit ndërkombëtar edhe në territorin e Shqipërisë, në variantin në të mirë si tubacion transit, pjesë e gazsjellësit Lindje-Perëndim (nga Bullgaria ose Greqia drejt Italisë), duke shfrytëzuar në këtë rast avantazhet që paraqet pozicioni gjeografik i Shqipërisë, si dhe territori shqiptar për infra-strukturën e gazit natyror".

Rovena Tashi

BB, 5 milionë euro për gripin e shpendëve

Fondi pritet të shkojë për pajisje dhe veshjeve speciale

Brenda këtij viti, Banka Botërore do të ofrojë për autoritetet shëndetësore shqiptare, 5 milionë euro për parandalimin e gripit të shpendëve. Konfirmimi është dhënë nga përfaqësuesit e misionit në Tiranë dhe fondi pritet të shkojë për blerjen e pajisjeve dhe veshjeve speciale. Pajisjet do të përdoren nga Instituti i Shëndetit Publik, për të analizuar kampionet e rasteve të mundshme që mund të paraqiten pas alarmit të dhënë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Ndërkohë që specialistët e Shëndetësisë do të pajisen edhe me mbrojtje speciale si: veshje, doreza dhe maska, për të kryer kontrole në vatrën e dekluarë si të rrezikshme ndaj virusit me origjinë aziatike. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka kërkuar së fundmi, marrjen e masave parandaluese të situatës së mundshme pandemike, si dhe miratjen e vigjilencës në të gjitha

vendet ndaj virusit H5N1, duke qenë se në këtë sezon mritet edhe mundësia e përhapjes së gripit, për shkak të emigrimit të shpendëve.

Kujtojmë këtu se vetëm para pak kohësh grupi task-force për parandalimin e gripit të shpendëve dhe OESH organizuan një takim për marrjen e masave konkrete në funksion të një koordinimi në të mirë të mërzhyrjes në fushën e



shëndetit njerëzor dhe shëndetit të kafshëve, forcimit të kapaciteteve kombëtare dhe lokale, zbulimit të diagnozës, monitorimit dhe parandalimit të gripit të shpendëve.

R.T.

Shkodra nen monitorim, frike nga gripi i shpendeve

Zonat me te rrezikuara te jene ne monitorim

Shkodër - Paralajmërimet për mundësinë e rishfaqjes së gripit të shpendëve në vendin tonë, kanë bërë që specialistë të bujqësisë dhe ushqimit të marrin masa për të parandaluar ndonjë situatë emergjente. Ndërsa në Shkodër nuk ka pasur ndonjë rast të evidentuar me H5N1, pozita gjeografike e këtij rajoni dhe prania e shpendeve shtegtare, bën që zonat me te rrezikuara te jene ne monitorim. Laguna e Vilunit, grykaderdhja e Bunes, Liqeni i Shkodres, jane dhe me te rrezikuara. Në lagunën e Vilunit, shpërdet shtegtare janë të shumta dhe deri tani nuk ka ndonjë problem, ndërsa janë dhe vete banoret e zonës së Velipojes, ku dhe ndodhet kjo laguna, te cilet janë te vlerësham ndaj këtij fenomeni. Në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Ushqimit meschet se nga rreth 450.000 shpende që mendohet te jene ne qarkun e Shkodres, ne 309.646 prej tyre eshte bere trajtimi perkatës kunder pseudopestit. Krahas shpendeve, jashte vlerësjes nuk janë lene dhe kafshet ku eshte bere gjurmimi per tuberkulozin dhe ne 3989 krere jane evidentuar 8 raste te dyshinta e pozitive, dhe ne 5 raste qe kane

rezultuar te prekur nga kjo sëmundje, eshte bere asgjësimi i tyre, ne miratim te Ministrise se Bujqësisë. Po keshtu, jane vaksinuar kunder plasjes 17.258 krere gjache, dhe 43.995 krere bageti te inta, kunder murtajes se demit 8884 krere dena, kunder brucelozes jane vaksinuar 28.251 krere bageti te inta, kryesisht qingja e keca. Sipas Adrand Gradecit, pergjegjës i inspektoriatit ushqimor te DEU-se ne Shkoder, jane bere kontrole dhe ne stabilimentet qe prodhojne produkte me origjine nga kafshet, si ne 50 barko, 4 pika tharjeje, 3 sallaneri. Po keshtu jane dhene 13 leje veterinarre per mritje e ngratje-shtirim kafshesh, dhe 26 leje per perpunim produktesh blegtorale. Problem per inspektoriatin e bujqësisë dhe ushqimit mbetet rihulumimi i plote ne kontrole te vazhdueshme i te gjithë njesive prodhuese e tregtuese ne Shkoder, ku vetem ne qytet jane rreth 1200 te tilla si dhe mos etiketimi ne gjuhen shqipe i atyre ushqimeve te ambalazuara qe vijne nga qytete te tjera. "Ato ushqime qe hyjne nga pikëkalimet kufitare te Shkodres i kane etiketat ne gjuhen shqipe", thote Gradeci.

A.D, gazeta Shekulli

Alarm për krizën energjetike në Greqi

Europa në krizë energjetike

Ekspertët: Rrezikohet importi gjatë muajve të dimrit

Ekspertët ndërkombëtarë të energjisë elektrike japin alarmin se Evropa kërcënohet nga kriza energjetike, si pasojë e mritjes së kërkesave dhe mungesës së investimeve të reja në stacionet që furnizojnë me energji.



Kriza energjetike parashikohet të prekë edhe Greqinë, çka pritet të transmetohet edhe në vendin tonë, për shkak se pjesa më e madhe e importit të energjisë në dimër bëhet nëpërmjet linjave të Greqisë.

SHQIPËRIA

Sipas ekspertëve vendas Shqipëria ka burime të mjaftueshme hidrike për të përballuar nevojat e veta energjetike, megjithatë gjatë muajve të dimrit e ka të pamundur të përballojë furnizimin me energji vetëm me prodhimin vendas, ndaj

detyrohet të importojë energji. Tashmë problemet e energjisë dhe mritjet energjetik të automatizuar në vendin tonë, do t'i shtohet edhe kriza botërore e energjisë.

FINANCIAL TIMES

Gazeta "Financial Times" citon kompaninë e këshillimeve industriale "Capgemini" me një studim për energjinë elektrike në Evropë. "Kjo duhet të shërbejë si një thirrje zgjimi për qeveritë e kontinentit, sepse jemi me të vërtetë në një zonë të rrezikshme dhe shumë shpejt mund të përballlemi me ndërprerje të energjisë",- kanë thënë përfaqësues të kompanisë.

Studimi ka paraqitur se në të rrezikuara nga kriza janë Greqia, Franca, Belgjika dhe Britania e Madhe, pasi kanë edhe rezervat në të pakta në këtë drejtim. Sipas ekspertëve, kërkesa për energji ka rritur për shkak të verave gjithnjë e më të nxehta dhe përdorimit të kondicionerëve. Një tjetër faktor janë procedurat komplekse që duhen për investime dhe ndërlikimet qeveritare po shkaktojnë mangësi në industrinë evropiane të energjetikës.

Rovena Tashi

Konferencë kombetare e shoqates se ujesjelles kanalizimeve te Shqipërisë

Në datë 18-20 Tetor në Tiranë, Shoqata e Ujesjelles-Kanalizime te Shqiperise zhvilloi Konferencen e saj te 6-te Vjetore. Ky eveniment shoqerohet me nje ceremoni speciale hapjeje per Konferencen dhe Ekspoziten dhe me nje program te pasur me prezantime profesionale mbi tema te rëndësishme per sektorin e ujit ne Shqiperi.

Tema e zgjedhur per Konferencen e 6-te Vjetore eshte: "Profesionalizem ne Menaxhimin e Sistemit te Ujesjellesave.

Konferenca u hap me nje Pritje Gala te mekuren ne nibeante, e cila u pershendetet nga shkelqesia e tij Z. Sali Berisha, Kryeminister i Shqiperise. Gjatë Pritjes Gala u hap zyrtarisht zona e Ekspozites dhe miqte mirepritene dhe pane produktet dhe sherbimet e ekspozuesve ne Konferencen. Kete vit nje zone e zgjeruar ekspozite perfshiu produktet e kompanive me te medha te ujesjelles-kanalizimeve.

Zhvillimi theksi nevojën per nje profesionalizem me te madh ne sektor. Profesionalizmi u trajtua ne sesione te tilla si:

- Bashkimi i ndërmarrjeve te ujit
- Monitorimi i Performances dhe Treguesve te Krahasuar
- Planifikimi i biznesit
- Sistemet e Informimit te Menaxhimit

• Politika e Burimeve te Ujit
• Programi i Drejtuesve te Rinj
Gjithashtu, nje vemendje e vecante iu kushtua statusit te projektve te trajtimit te ujarave te ndertura ne te gjithë Shqiperine, si dhe u trajtuan pervojat e ndajzara ne kete drejtim.

SITUATA: Mungojnë mjetet e duhur tek zjarrefikësit

Zjarri shkruan pishat mbi 50- vjeçare

Mungesa e rrugës bën që zjarrefikësit vetëm të vëzhgojnë djegien e pyllit



Berat - Një zjar ka përfshirë kodrën në Urën Vajzurore, e cila është shkruanuar e tëra pasi mjetet e zjarrefikësve nuk kanë mundur të shkojnë deri në vendngjarje. Mungesa e rrugës ka bërë që kalimi të jetë i pamundur gjë që ka sjellë përhapjen e zjarrit në të gjithë pyllin me pisha gjysëm shekullore me sipërfaqe një hektar.

Shkaqet
Tashmë kanë filluar edhe hetimet për të gjetur shkaqet e shkruanimit të këtij masivi pyllor por deri tani nuk ka asnjë version zyrtar. Nga ana tjetër zyra për mbrojtjen kundër zjarrit, që duhet tu përgjigjet me shpejtësi dhe efikasitet këtyre rasteve, nuk ka mjetet e duhura për të shmagur

ngjarje të tilla.

Më problematik ky problem bëhet në terrene ku mungon infrastruktura rrugore. Ky shënon rastin e dytë brenda pak kohësh, që flakët përfshijnë këtë zonë. Pak kohë më parë u dogjën 50 hektar pyje në Berat.

R. Tashi



SKANDAL: Shkodër

Konflikti i peshkatarëve zbulon një pronar të ishullit Sa zona të tjera të mbrojtura janë shitur?

Shkodër- Liçenca e peshkimit për peshkatarët e ishullit të Dajlanit është anuluar pasi kjo zonë është privatizuar. Të hipur në varka, forcat policore kanë zbardhur në

se Bashkia Shkodër në vitin 2001 ka privatizuar duke i dhënë personave të tjerë (familjes Isufi) 1000 metër katror në veri e jug të ishullit. Sipas tij kjo është

jashtë nga vendi ku ne kemi punuar tërë jetën, dhe pse kemi dokumente, harta, licensë etj. Përfaqësuesit e Bashkisë nuk janë paraqitur në gjyq i cili është anuluar, ndërsa nga ana tjetër policia thotë se ka urdhër nga bashkia për të na nxjerrë jashtë"

Tek mundohen të na sqarojnë pse kanë të drejtë nga ana ligjore dhe morale kolegu I tij peshkatar Zija Pruja shton se ka rreth 30 vjet që merret me peshkim. "Kur u privatizua ndërranja, ishulli nuk u privatizua pasi nuk e lejoi ligji një gjë të tillë. Ndërsa tani del se i ka dalë pronari dhe bashkia ia ka dhënë të drejtën me e marrë. Ne nuk duam të shkelim ligjet e shtetit, duam që Dajlani të funksionojë, të shërbejë për të zënë peshk brez pas brezi. Disa dalin në pension, të tjerë peshkatarë futen në punë, pa e trashëguar ne, pasi nuk jemi pronarë të tij".

Peshkatarët e Dajlanit shprehen se kanë investuar këtu dhe bashkia as që ka dashur t'ja dijë për këtë. Në kontratën për dhënie në përdorim të aseteve të Dajlanit, peshkatarëve, janë shkruar dhe kufijtë që përshijnë pjesën para lumit Bura, përgjatë kanalit të këtij lumi deri tek ishulli në liqenin e Shkodrës me gjërësi 250- 300 metër, dhe pas lumit Bura deri tek shkëmbi tek fabrika e çimentos.

REAGIMI


Të pyetur nga gazeta, zyra e shtypit e Ministrisë së Mjedisit mohon se ka dijeni për shitjen e ishullit. Sipas zyrtarëve të këtij dikasteri gjithçka është brenda rregullave dhe liçenca e shfrytëzimit pronarëve të mëparshëm i është hequr pasi kanë patur probleme me drejtësinë. Ndërsa përse i përket akuzave të

mbrojtësit ligjor të peshkatarëve i cili akuzon Xhuvelin për afere komptive në shitjen e Dajlanit, Ministria i ka quajtur të pakaza dhe ka sqaruar se ai nuk është kryetar i partisë agrare të shkodres, sic është paraqitur para medias.

BASHKIA

Zyra e medias e Bashkisë së Shkodrës shprehet për gazetën "Ekolëvizja" se kjo leje për privatizimin e 1000 metrave katror është dhënë nga drejtuesit e kaluar të pushtetit vendor, megjithatë procedurat e kontrolluara nuk kanë zbuluar shkelje. Por drejtuesit

tuar me kryetarin e bashkisë, Artan Haxhi. Janë drejtuar tek prefekti Kolonbi dhe pasi e kanë njohur me të gjithë dokumentet që disponojnë, kanë kërkuar ndërranjen e tij për zgjidhjen e këtij problemi. Prefekti iu ka thënë që të bëjnë një deklaratë dhe më pas ai do të komunikojë me dikasterin që u ka dhënë lejen e shfrytëzimit të ishullit si dhe me bashkinë që i ka larguar. Sipas policisë, është një urdhër i dhënë për ekzekutim dhe ne e zbatojmë. Peshkatarët shtojnë se duan të kenë afat moshëgjatë deri në marrjen e një vendimi nga gjykata.



Ishulli që është shitur

ishullin e Dajlanit, ku kanë dëbuar dhunshëm peshkatarët prej vendit të peshkimit në lumin Bura.

Sipas peshkatarëve kjo ka ardhur pasi Ministria e Mjedisit u ka anuluar kontratën 10 vjeçare të peshkimit. Në letërën e ministrit Xhuveli thuhet se liçenca anulohet për arsye të shkeljes së ligjit. Përfaqësuesi ligjor i peshkatarëve, që edhe përfaqësues i partisë agrare për qytetin e Shkodrës, akuzon shefin e vet partiak dhe njëkohsisht ministër i Mjedisit, Lufter Xhuvelin, si të përfshirë në afere komptive për çështjen e Dajlanit.

DËBIMI

Megjithëse situata është për shqyrtim në Gjykatë, dhe peshkatarët kanë një kontratë përdorimi deri në 2014, ata janë detyruar të largohen nga puna, pasi mendohet se bashkia e ka privatizuar ishullin e Dajlanit.


Administratori i firmës "Dajlani", Musa Xhaka shprehet

krejtësisht e padrejtë pasi bën që të hidhen në muqë 16 peshkatarë.

Administratori Xhaka thekson: "Në vitin '98 kërkuam që këta peshkatarë ta privatizonin, siç ishte bërë me dy pjesë të tjera të ish-ndërranjes së peshkimit në Shkodër, por nuk u pranua". Ai tregon se peshkatarët janë kujdesur për mirëmbajtjen e ishullit edhe gjatë vitit të shkatërrimeve 1997 dhe kanë kontratë shfrytëzimi edhe për 7 vite të tjera dhe është e padrejtë që të flaken jashtë tij.

PRIVATIZIMI I ISHULLIT

Tek bisedojnë me një nga peshkatarët ai sqaron se kjo që po ndodh nuk ka logjikë. Peshkatarë Muhamet Plisi shprehet "Bashkia është në gjyq me ne pasi ka thyer ligjin duke privatizuar ishullin në 2001, ndërsa ne që kemi tërë jetën këtu, kemi vazhduar të peshkojmë e paguajmë detyrimet prej 70.000 lekësh në muaj. Pse ne nuk mundëm ta privatizojmë, të tjerët po. Sot vjen policia dhe na nxjerrin



Kanë ushtruar aktivitetin e peshkimit në ishullin e Dajlanit për plot 30 vjet Tashmë peshkatarët kërcënojnë se do të hidhen në grevë urie, nëse bashkiakët i ndalojnë që të peshkojnë.

e Bashkisë në të madhe të veriut hezitojnë të konfirmojnë faktin e shitjes, aq më shumë kur i kërkuam të na paraqesin dokumentat rreth të.

Peshkatarët, disa prej të cilëve kanë rreth 30 vjet që punojnë këtu, e kanë vazhduar këtë aktivitet duke patur liçensën përkatëse.

TAKIMI

Peshkatarët kanë shkuar në bashkinë e Shkodrës ku janë

DAJLANI

Ishulli i Dajlanit njihet historikisht me Shkodër si zonë peshkimi, ku gjyeteja e peshkut bëhej e regullt dhe sipas kriterëve. Në zbatim të vendimi të ministrit Xhuveli, forca të shumta police janë vendosur në ishullin e Dajlanit 2 kilometra larg qytetit të Shkodrës, aty ku bashkohet Bura me Drinin.

Ministria e Mjedisit si Shvejku:

"Ç'më duhet mua se ç'dua unë"

Ishulli i Dajlanit në Burë është shitur. Me ligj nuk lejohet të shiten tokat dhe mjediset ujore aq më shumë kur këto janë zona të mbrojtura dhe përfshihen në Konventën Ramsar ku hyjnë mjediset në të mira të botës. Pra dikush e ka shitur në mënyrë të paligjshme dhe pikërisht në vitin 2002, kur Xhuveli ka qenë përsëri ministër i mjedisit. Në Ministrinë e Mjedisit të gjithë e dirë që ishulli është shitur. Por të gjithë quditen se si mund të shiten një pronë publike. Po që se ato shiten, ata mund të ishin të parët që do t'i blinin se jua dinë më mirë se gjithkush vlerat që kanë. Por Xhuveli përsëri nuk quditet. Ndoshta sepse ai e di që kjo është një rrodhi që ka rrodhur dhe në dhjetëra parçe dhe zona të tjera të

mbrojtura të vendit tonë, kështu që për të nuk është ndonjë çudi



apo gjë e jashtëzakonshme. "Ne nuk dinë kush e ka shitur - thonë disa specialist të Ministrisë, re nuk mund shesim mjediset".

Por për shoqërinë është e

quditshme dhe fakti përse Ministri i Mjedisit nuk del para publikut dhe

të sqarojë përgjegjësinë që ka në mbrojtjen e këtyre pronave publike, të cilat i janë besuar atij për t'i ruajtur nga rreket e disave.

Urdhëri për largim në 2003

Vendimi i parë për largimin e peshkatarëve nga Dajlani daton me 7 tetor të vitit 2003. Dajlan shpik ka dorëzuar në gjykatë dokumentin në bazë të së cilit vërtetohet se, 16 punonjësit janë regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës si "Dajlani" sh.p.k. për zënie dhe tregtinë e peshkut. Shoqëria tregtare "Dajlan" sh.p.k është e regjistruar si e tillë me vendimin nr 17735 datë 17.09.1997 në gjykatën e Tiranës. Aktiviteti i saj është zënia dhe tregtimi i peshkut në ujërat e lumit Bura dhe liqenit të Shkodrës. Me datë 16.11.2004, kjo shoqëri ka lidhur kontratë me Ministrinë e Ekonomisë, nga ana e së cilës i është dhënë ishulli me qera për 10 vjet, deri në vitin 2014.

"Brenda qirasë për përdorim është objekti në ishullin e Dajlanit, me sipërfaqe 198 metra katrorë si dhe sipërfaqja ujore 642 metra katrorë". Bashkangjitur me këto dokumente, ka qenë dhe urdhri i Bashkisë së Shkodrës për largimin nga ishulli, urdhër ky i miratuar edhe nga Prefektura. Bazuar rreth dokumentacionin e paraqitur, si dhe nga fakti se peshkatarët e Dajlanit do të kishin huroje të mëdha ekonomike,

- Pasurisë kombëtare i ka dalë pronari, ndërsa bashkia shkel kontratën e bërë mes peshkatarëve dhe Ministrisë së Ekonomisë.
- 16 peshkatarë janë urdhëruar të largohen nga Dajlani, për shkak të pronësisë rreth ishullin, ndërkohë që për ta është dhënë leja për ta shfrytëzuar deri në 2014
- 5 vjet kanë kaluar nga vendimi i Bashkisë së Shkodrës, i cili e vlerësoi ishullin pronë të një personi, pavarësisht deklaratave të bëra se nuk mund të privatizohet Dajlani
- 198 metra katrorë sipërfaqja e ishullit të Dajlanit
- 642 metra katrorë sipërfaqja ujore



Biznesi kanceroz i ministrit Lufter Xhuveli

Nga Kristi Pindëri

Shqiptarët e njohin si ministrin më jetëgjatë dhe më fjalëpakë, por në të vërtetë, enri i drejtuesit të dikasterit të Mjedisit, z. Lufter Xhuveli, duhet të hyjë në histori si enri i mbotësisit më të madh të mjedisit në Shqipëri.

Ish-ministri i preferuar i Fatos Nano, i cili i shkoi të gjithë pas zgjedhjeve të 3 korrikut 2005 kur lidhi një aleancë të paprecedentë me kryeministrin e sotëm Sali Berisha, për të ripërfitur portofolin e mjedisit, është në fakt, një ndër importuesit më të mëdhenj të gomave të përdorura.

Këto goma, prej disa vjetësh konsiderohen në Kontinentin e Europës si: "mbeturina të rrezikshme që duhen trajtuar në mënyrë të posaçme". Importimi i tyre në Shqipëri përbën automatikisht një rrezik të paimagjinueshëm jo vetëm për mjedisin, por edhe për shëndetin e mbi 3 milion shqiptarëve.

Bashkëshortja e ministrit, znj. Mejto Xhuveli, rezultoi të jetë pronarja e një toke prej 6 mijë metrash katrorë në afërsi të Fierit, mbi të cilën është ngritur një impiant për riveshjen e gomave, që në të vërtetë, funksionon vetëm si një pikë shitjeje me shumicë dhe pakicë e gomave të përdorura.

Toka mbi të cilën është ngritur e ashtuqajtura fabrikë për riveshjen e gomave të nxjerra me marifet nga territori i BE-së, si dhe vetë fabrika, janë zyrtarisht pronë e znj. Mejto Xhuveli dhe nipit të tyre Agron Askushi. Por, që nga marsi i këtij viti, licenca për riveshjen e gomave, është regjistruar në emër të vajzës së çiftit Xhuveli, Alta Xhuvelit.

Lajmi u bë i ditur për "MAPO"-n, nga deputeti i partisë së Xhuvelit në Kuvendin e Shqipërisë, z. Nikolla Neranxi, ndërsa u konfirmua nga disa persona të tjerë në qytetin e Fierit, të cilët kërkojnë të mos identifikohen.

Gomat e përdorura, më toksike se gjarpërinjtë me helmues...

Në vitin 1996, Shqipëria e kishte të ndaluar rreptësisht importimin e gomave të përdorura, nga vendet e Bashkimit Europian.

Në kulmin e situatës më problematike të historisë shqiptare gjatë këtij tranzicioni, pra në fund të vitit 1997,

Kuvendi aprovoi ligjin e vjetër duke lejuar importimin e gomave të përdorura vetëm nga ato subjekte që do të mund

mbështesin amendamentet e tij, Berzani kërkoi të ndalohej importimi i gomave të konsumuara si dhe i

cilat për shkak të purës së tyre direkte me ministrin Xhuveli, kërkojnë gjithashtu të mos identifikohen.

Sipas ligjeve në fuqi të çdo vendi europian, gomat e përdorura duhet të digjen në disa impiante të posaçme, tepër të kushtueshme të cilat jo vetëm që i eliminojnë ato krejtësisht por nga ana tjetër, përmes filtrave të veçantë nuk shkarkojnë në ajër asnjë substancë vdekjeprurëse. Sigurisht, kjo dëgjie kushton shumë, ndaj biznese të ndryshme në BE janë jashtëzakonisht të interesuara që në vend të dëgjies, t'i eksportojnë këto goma në vende ku ligji ka shumë më pak fuqi... si në Shqipëri... Ndërsa ato konsiderohen nga specialistët si më toksike edhe se gjarpërinjtë në helmues që rriten në territorin e Shqipërisë edhe pse efektin helmues e japin në mënyrë të ngadalshme...

Çfarë ndodh me "trafikun" e gomave?

Kushdo që zotëron goma të tilla të përdorura, në vend që të paguajë miliona për t'i djegur ato, i paguan në dorë, vetëm 0.5 dollarë, ndërsa importuesi të tyre. Që do të thotë se importuesi shqiptar, në këtë rast, marrë në dorë 0.5 dollarë për çdo copë gomë të përdorur në Greqi apo Itali, e importon atë në Shqipëri dhe menjëherë e shet me pakicë ose me shumicë

depozitimi të gomave të përdorura (që 'vdesin' shumë më herët se gomat e reja). Ndaj edhe ato emërtohen si edhe më lart: "mbeturina të rrezikshme eliminimi i të cilave i kushton shumë shoqërisë"... Automatikisht vendi shndërrohet në një "superdepozitë" e kimikateve të rrezikshme, eliminimi i të cilave në një të ardhme do t'i kushtojë direkt, xhepit të çdo qytetari!

Kur u miratua në vitin 1997 ligji që lejonte importimin e gomave të përdorura në Shqipëri u shënuar edhe kulmi i këtij biznesi! Sipas një raporti të "Qendrës Mjedisore për Administrimin dhe Teknologjinë, Tiranë", rezultoi se në fund të vitit 1997, viti i mungesës absolute të shtetit dhe të ligjit, në Shqipëri kanë hyrë mbi 120 mijë copë goma të përdorura...

Ligji...

Ministri aktual i Mjedisit, z. Lufter Xhuveli ka llogaritur që të miratohet ligji në fjalë për importin e gomave, por ana, ai rezultoi të jetë shkëlësi i parë dhe me i madh, i atij ligji.

Ndërsa familja e tij është e pajisur me një licencë për riveshjen e gomave, ky proces nuk ndodh më në "fabrikën" e pozicionuar 5 km në hyrje të Fierit.

Qytetarë të Fierit, të interesuar direkt për blerjen e gomave thonë se "në këtë



"Kur u miratua në vitin 1997 ligji që lejonte importimin e gomave të përdorura në Shqipëri u shënuar edhe kulmi i këtij biznesi! Sipas një raporti të "Qendrës Mjedisore për Administrimin dhe Teknologjinë, Tiranë", rezultoi se në fund të vitit 1997, viti i mungesës absolute të shtetit dhe të ligjit, në Shqipëri kanë hyrë mbi 120 mijë copë goma të përdorura..."

të realizonin përmes një licenze rigoroze, riveshjen e tyre.

Ligji u miratua menjëherë në Kuvend ndërsa shumë pak njerëz pyetën me dyshim: cili lob i fuqishëm në Shqipëri mundësoi miratimin e një ligji të tillë, që dëmtonte direkt shëndetin e miliona njerëzve?

Nikolla Neranxi, deputeti "rebel" i agrarëve, i cili e ka akuzuar kryetarin e tij se e ka kërcënuar edhe për jetën, shprehet për revistën se "ishite pikërisht Xhuveli ai që mundësoi me gjithçka, miratimin e tij ligji".

Ky ligj u kundërshtua ashpër në vitin 2003 nga reformatorët e Genc Pollos, të cilët ishin atëherë "amiq politikë" me Xhuvelin. Njëpëmjet një projektligji të depozituar pranë Kuvendit si dhe një projektrezolute, deputeti i PDR-së, Ilirjan Berzani, kërkoi atëherë që të merren masa kundër ndotjes së ambientit. Duke u bërë thirrje grupeve parlamentare që të

automjeteve që janë të përdorura më shumë se 6 vjet.

Por importi i tyre ishte shndërruar ndërkohë në një monopol fitimprurës jo vetëm për pak njerëz në Shqipëri, por edhe për të tjera subjekte jashtë vendit tonë, të cilat mund të përfitonin shumë nëse "i hiqnin qafe" gomat e përdorura, nga territori i vendeve të tyre.

Ato janë të tejbushura me dioksinat dhe furane, elementë kimikë këto tepër të rrezikshme për shëndetin e njerëzve, shkaktare të disa llojeve të kancerit të njeriu. Komuniteti Europian, i shqetësuar, ka marrë masa të ashpra kundër kësaj përbërjeje kimike. Nëse nuk digjet (dhe procesi i djegjes kushton shumë) por thjesht depozitohen në ambient, këto produkte konsiderohen si depozitime të rrezikshme, të pashpërbësme, që mund të shndërrohen në fole të insekteve të ndryshme. Këtë fakt e konfirmojnë burime pranë Ministrisë së Mjedisit, të



duke përfituar shumë më tepër. Në "fabrikën" e zotit Xhuveli, një çift gomash të tilla të përdorura kushton 35 mijë lekë të vjetra!

Dëmi në mjedis është minimal nëse gomat e importuara shërbejnë sërish si goma për makinat, pronarët e të cilëve mendojnë se do të kursejnë më pak nëse blejnë me çmim tepër të ulët goma të tilla të përdorura. Por në një plan strategjik, kuptohet se në këtë mënyrë, Shqipëria shndërrohet në një vend

fabrikë është bërë dikur riveshja e gomave, por tashtë nuk bëhet më!"

Deputeti Neranxi dëshmon të kundërtën: ai thotë për "MAPO"-n, se në këtë "fabrikë", nuk është bërë asnjëherë riveshja e gomave, madje në brendësi të saj nuk ka as edhe instalim elektrik!

Revista disponon foto ekskluzive të ambienteve të brendshme të kësaj fabrike, që në të vërtetë duket më shumë një magazinë gomash sesa një fabrikë emirëfilltë!



Faktin që fabrika nuk bën më riveshje të gomave, por ana, nga ana tjetër vazhdon të shesë goma të përdorura e konfirmojnë edhe punonjës të saj.



Bashkëshortja e ministrit, znj. Mejto Xhuveli, rezulton të jetë pronarja e një toke prej 6 mijë metrash katrorë në afërsi të Fierit, mbi të cilën është ngritur një impiant për riveshjen e gomave, që në të vërtetë, funksionon vetëm si një pikë shitjeje me shumicë dhe pakicë e gomave të përdorura.

Ata konfirmojnë edhe faktin që atje shiten goma me shumicë, të cilat padyshim blihen nga subjekte të cilat i blejnë ato për të proceduar me djegien e gëlqeres, duke qenë se gomat janë një lëndë djegëse e përkryer për këtë qëllim.

Xhuveli ka nxjerrë para pak kohësh një urdhër formal për ndalimin e furnave të gëlqeres në Shqipëri, e sidomos atyre në Krujë të cilat përdorin si lëndë djegëse gomat e përdorura, por pas një inspektimi që bënte në këtë zonë, konstatoim se djegia e tyre vazhdon. Tymi i zi që çlirohet nga kjo djegie, është i papërballueshëm për mushkëritë njerëzore mërkohë që vazhdon ta sfuonjë qiellin e kaltër të zonës së Krujës, trenësisht afër kryeqytetit ku mendohet se jeton 1/3 e popullsisë shqiptare..

Fabrika...

Të shqetësuar nga ky fakt, vendosëm të "inspektojmë" fabrikën në fjalë..

Pak pas mesditës, fabrika në rrugën nacionale, 5 km përpara se të hysh në qytetin e Fierit, duket e shkretuar..

E ndërtuar me një material të bardhë parafabrikat, që ngrihet mbi themele të zakonshme, kjo ndërtesë, e ngjashme në shumë me një magazinë se me një fabrikë, shtrihet në një sipërfaqe jo më të madhe se 500 metra katrorë. Në pjesën e mbrapme të saj, disa shkallë prej hekuri të çojnë në një derë të vogël, në një verandë ku duket edhe një dritare. Ngjan me një ambient që nuk mund të jetë veçse një

zyrë, ndërkohë që është shumë më komod se pjesa e përparme e fabrikës, e cila mund t'i duket kujtob që kalon me makinë si një pikë e zakonshme për shitjen e gomave.

Djaloshi, banor me siguri i ndonjë fshati përreth, duket shumë jashtë qenies së tij të thjeshtë dhe madje shumë formal për moshën që ka, teksa artikulon me mundim fjalinë informacion". Duket qartë se dikush mund ta ketë instruktuar të përgjigjet ashtu...

Tëksa i afërmi qytetit të Fierit, dallojnë buzë rrugës tre pika të tjera shumë të vogla ku shiten goma të përdorura. Edhe ato, janë të mbyllura, ndonëse është ditë dhe orar i zakonshëm pune!

Në hyrje të qytetit të Fierit telefonoj personin e kontaktit numri i të cilit shkruhet në tabelën e fabrikës. Zilja bie disa

Në anën veriore të saj, kufizohet me fabrikën e miellit "Mulliri i artë", i ndërtuar atje që nga viti 1994.

Një dryn i madh mbyll një derë të gjatë prej hekuri, fare pak metra larg derës balllore të ndërtesës, ku lësh një qen i mitur pastor gjerman, që duket racë e pastër.

Buzë rrugës, si edhe në brendësi të dorrit, ndodhen dhjetëra goma të përdorura, të paveshura, të cilat reklamohen si "goma për t'u shitur", në një tabelë të madhe në fund të së cilës shkruhet një numër kontakti, me kontratë, që përfundon me shifrat ..879.

Pranë nesh afrohet një person që duhet të jetë roja. Biseda është shumë e shkurtër. E pyesim nëse shet goma të përdorura. Përgjigjet "Po, por tani e kemi të mbyllur". Kërkojmë të dimë çmimin, duke iu drejtuar me një ton të qetë dhe, ndërsa presim përgjigjen, kalon një pauzë vetëm disa sekonda gjatë të cilave na shikon me dyshim. "35 mijë lek të vjetra, çift", përgjigjet. "Po me shumicë, a shisni?", e pyesim. "Po, edhe me shumicë, por nuk e di çmimin". Biseda vazhdon si më poshtë:

- Janë goma të përdorura të gjitha, apo shisni edhe goma të reja?
- Jo jo, janë vetëm të përdorura!
- Po rikqerton (riveshjen e gomave me gomën e re), e bëni?
- Jo
- Po neve na thanë se e bënit, prandaj erdhëm këtu...
- Po, e bënim por tani nuk

e bëjnë më.

- Po sa ka?

- Ka tre ditë që është bllokuar puna fare se patëm ca probleme...

- Aha, qartë. Po vazhdoni të shisni?

- Po, po, por hajdani nesër më mirë se unë nuk kam asnjë informacion...

Djaloshi, banor me siguri i ndonjë fshati përreth, duket shumë jashtë qenies së tij të thjeshtë dhe madje shumë formal për moshën që ka, teksa artikulon me mundim fjalinë informacion". Duket qartë se dikush mund ta ketë instruktuar të përgjigjet ashtu...

Tëksa i afërmi qytetit të Fierit, dallojnë buzë rrugës tre pika të tjera shumë të vogla ku shiten goma të përdorura. Edhe ato, janë të mbyllura, ndonëse është ditë dhe orar i zakonshëm pune!

Në hyrje të qytetit të Fierit telefonoj personin e kontaktit numri i të cilit shkruhet në tabelën e fabrikës. Zilja bie disa



Në kulmin e situatës më problematike të historisë shqiptare gjatë këtij tranzicioni, pra në fund të vitit 1997, Kuvendi amendoi ligjin e vjetër duke lejuar importimin e gomave të përdorura vetëm nga ato subjekte që do të mund të realizonin përmes një licence rigoroze, riveshjen e tyre.

Ligji u miratua menjëherë në Kuvend ndonëse shumë pak njerëz pyetën me dyshim: cili lob i fuqishëm në Shqipëri mundësoi miratimin e një ligji të tillë, që dëmton direkt shëndetin e miliona njerëzve?

herë por nuk ka përgjigje.

Vetëm pak minuta më vonë, marr telefonatë nga numri në fjalë. "Çfarë kishit?", dëgjoj të më pyesë një zë me dialekt fierak. "Më falni që ju shqetësova, por kalova rrugës dhe doja të dija nëse shisni goma me shumicë, pashë numrin tuaj në tabelë dhe meqë nuk kishte asnjë njeri ju telefonova", përgjigjem. "Po, nga jeni ju?", më pyet personi. "Unë jam nga Tirana". "Aha, kaq kishit?", thotë ai. "Po", i përgjigjem dhe menjëherë ndiej se e mbyll telefonin pa më dhënë asnjë

shpjegim tjetër.

Tre orë më vonë, teksa ndodhem në Tiranë, marr një telefonatë nga një numër i zakonshëm celulari që përfundon me ...002. dëgjoj një zë mashkulli, me dialekt veror që prezantohet si punonjës i Ministrisë së Brendshme dhe më pyet: "Dëgjo, kam këto numrat e gazetarëve këtu, ti për cilën gazetë punon?"... E pyes për identitetin e tij dhe më përgjigjet duke artikuluar një emër mëse të zakonshëm verior.

Xhuveli prononcohet...

Morëmje! Akrepi ndodhet shumë afër orës 22.00... Vonë për një ministër, megjithatë vendos të fomoj numrin. Më përgjigjet pas ziles së dytë, ministri Luftër Xhuveli, dora vetë! Pasi i parashtroj të gjitha faktet dhe detajet, të cilat i dëgjon me një durim mbresëlënës, më përgjigjet: "Dëgjo djalë: nuk kam asnjë dëshirë të merrem me akuzat! Ka ligje në këtë vend, ka edhe

Korrupsioni në mbrojtjen e mjedisit

Metamorfoza për ligjin e gomave të përdorura tregon se ka raste që shteti i bën ligjet nisur nga interesat e përfitimeve personale të një individi apo grup individësh ndonëse ato publikohen si ligje për të mirën e tërë shoqërisë.

Ndihni kronikën e ligjit për gomat e përdorura në Shqipëri:

Në vitin 1993 Komiteti i Mjedisit dhe Ministria e Shëndetësisë që e mbulon dhe mjedisin, nxorën ligjin "Për ndalimin e importimit të gomave të përdorura për shitje dhe riveshje". Ky ligj ishte vërtet i domosdoshëm në atë kohë sepse shumë "kompani" të huaja bënin presion për të ngritur biznese mbështetur në eksportimin e këtyre mbeturinave të Europës në vendet që nuk ishin të përgatitura me ligjet Europiane për mbrojtjen e mjedisit të tyre. Eurpa kishte kohë që e ndalonte eksportimin dhe importimin e tyre duke i konsideruar ato ndër mbetjet më rrezikshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Në vitin 1997, ligji u hodh posht dhe në vend të tij doli një vendim i Këshillit të Ministrave i cili lejonte të importoheshin gomat e përdorura me qëllim riveshjeje. Si paralajmëronte Green Peace, këta "bизнесmenë" nuk do t'i vënë kurrë në punë makineritë e veshjes së gomave, se fitojnë direkt nga shitja e tyre ashtu si importohen. Dhe vërtet kështu ndodhi.

Në vitin 1999, disa deputet idealist e ngritën prap problemin e ndotjes që sjellin gomat e importuara në Shqipëri dhe arritën që ta vendosin përsëri ligjin për ndalimin e importit të tyre.

Por shumë shpejt reagues biznesmenët politikan dhe po në vitin 1999, ata arritën ta anulonin përsëri ligjin dhe të ligjërojnë importimin e tyre, pra djegjen e tyre në Shqipëri.

Deputetët idealist nuk u kujtuan më të pyesnin se sa mijra goma mbeturina hyjnë çdo vit në vendin tonë dhe çndodh me to. Ministri i Mjedisit që e ka patur dhe e ka për detyrë këtë kontroll, jo vetëm s'e ka bërë këtë por perkurazoi e ka fshehur. Por vdekjet nga kanceri që shkaktojnë furanet dhe dioksinat e çliruara nga gomat nuk mund të fshihen. Ju kujtojmë deputetëve se dhe ata këtë ajër që thith gjithë populli marrin dhe se gjatë 10 vjetëve të fundit numërohen rreth 8 deputet që kanë vdekur nga kanceri, ju kujtojmë dhe fëmijët e tyre që sab të izolohen në shtëpitë dhe makinat lluksoze, përsëri ajrin me dioksina dhe furane do të thithin. A ja vlerë pra të heshtin?

Tirane, tetor 2006



E veçantë

Mace e qen, paradë edhe në Shqipëri

Macja me e bukur u shpall një race persian 9 vjeçe

Nga Elvis Çela

Tiranë - Në një sallë, e cila në fundjavë apo ditë të tjera ka mbledhur shikues për aktivitetet të natyrave kulturore, argëtuese dhe sociale, për të parën herë ishin mbledhur dashamirës së kafshëve duke krijuar në këtë mënyrë një atmosferë krejt të veçantë.

Festa e kafshëve u organizua posaçërisht për të promovuar dhe nxitur më tej përkujdesjen dhe shoqërimin ndaj kafshëve të buta. Ndërsa motoja e javës së parë të tetorit ishte gjithë përfshirja për kafshët e buta në përgjithësi; për të marrë pjesë në festë u përzgjodhën kafshë shtëpiake, 20 qen dhe 5 mace. Kjo për të promovuar idenë e javës së mirëqenies së kafshëve dhe në pas për ta kthyer atë në një traditë të përvitshme.

Hera e parë ishte edhe për shoqëruarit e kafshëve shtëpiake, që të sfilonin me qentë dhe macet e tyre në sallën e vogël të Qendrës Ndërkombëtare, e cila i kaloi shumë shpejt emocionet në kënaqësi, jo vetëm për kafshët, por edhe për shoqëruarit, organizatorët dhe njerëzve që

qëndronin pas kuintave.

Në përfundim të festës u shpallën dhe kafshët fituese për vitin 2006-të, përkatësisht: macja me e bukur u shpall Viki, raca:



persiane e bardhë, moshë: 9 vjeçe, me kujdestare Valbona Dervishini; macja më llupëse u shpall Mezza, raca: Turkish-angora, moshë 6-muajshe, me kujdestare Enida Jashari; qeni më i bukur u shpall Lordi, raca: dalmat, moshë 1 vjeçe, me kujdestar Klaus Mxaxhiu; qeni më llupës u shpall Sparki, raca: spitz-gjerman, moshë: 6-muajsh,

me kujdestar Jona Dividi.

Ndërsa ishte hera e parë ku në Shqipëri zhvillohej një festë e tillë, shoqëruarit e kafshëve, të interesuarit, specialistë të fushës

etj, e vlerësuan nismën, idenë e aktivitetit dhe u shprehën shumë entuziast pas mbarimit të "Festës së Kafshëve".

Përse kjo festë?

Megjithë suksesin dhe risinë që solli "Festa e kafshëve" jo pak mund të jenë ata që mund të pyesin: përse kjo festë? Kjo festë,

e para e llojit të saj në Shqipëri, ishte faza e tretë e aktivitetit. Faza e parë shërbeu për sensibilizimin e publikut, sensibilizim, i cili u bë me anë të disa materialeve për kujdesin që duhet treguar për kafshët shtëpiake (qenin dhe macen) si dhe materiale për ringjalljen e kopshtit zoologjik.

Faza e dytë vazhdoi me guidat natyrore, organizuar prej Guidave Natyrore të Qendrës "EDEN" në bashkëpunim me anëtarët e "Shoqatës së Mjekëve Veterinarë të Shqipërisë", për katër shkolla 9-vjeçare të Tiranës. Përveç guidës së organizuar në ambientet e kopshtit zoologjik, mënësit u njohën me kafshët e kopshtit, sjelljen e tyre, mënyrën e të ushqyerit etj. Gjithashtu ata u njohën me rëndësinë që kanë kafshët e buta në përgjithësi dhe ato shtëpiake në veçanti në jetën enjazit.

Fëmijët i duan kafshët, ndaj një kujdes për kafshët e buta dhe nëse përkujdesi për këto kafshë është i përhershëm, do të ulim së shunti numrin e qenve dhe maceve të rrugës, si dhe shmangim sëmundjet e ndryshme që shkaktohen nga këto kafshë, të

cilat sipas specialistëve këto vitet e fundit janë shtuar së shumti, duke shkaktuar probleme serioze tek shëndeti i njerëzve.

Në të gjitha vendet e botës java e parë e tetorit i është përkushtuar kafshëve të buta, ndërsa në vendin tonë, kafshët, kryesisht ato të shoqëruarit shihen thjesht si dojtë për të luajtur dhe hequr stresin e përditshëm, duke mos i konsideruar ata si bashkëvetarë të jetës tonë.

Përveç sensibilizimit, festa e kafshëve solli në fushën e Qendrës "EDEN" një eksperiencë të re dhe shumë interesante, eksperiencë e cila mund të adaptohet më së miri në edukimin dhe ruajtjen e mjedisit; nëse përkujdesemi për kafshët e shoqëruarit jo vetëm që do të ruajmë shëndetin e tyre, njerëzve dhe mjedisin në të cilin jetojnë këta të fundit.

Kjo dite tashme u festua edhe në vendin tonë, kështu që Qendra "EDEN" në bashkëpunim me aktorë të tjerë do ta kthejë në ritualin e saj të përvitshëm këtë nismë, duke kontribuar gjithnjë e më tepër për edukimin mjedisor në Shqipëri.

Qendra "EDEN"

"Shumë grupe të vegjël njerëzish, në shumë vende të vogla, duke bërë shumë gjëra të vogla, janë duke transformuar botën".

Java Evropiane e Qarkullimit, nuk ndjehet në Shqipëri

Gjithsecili mund të kontribuojë për uljen e ndotjeve e zhurmës

Java Evropiane e Qarkullimit nuk është dëgjuar në Shqipëri ndryshe nga mjaft vende të tjera Evropiane.



Klima dhe ndryshimet klimatike si diçka abstrakte, që nuk mund të shihet, nuhatet apo ndihet, dhe me efekte që shfaqen në të ardhmen është e vështirë për tu përcjellë. Megjithatë, duke dhënë shembuj dhe duke përdorur ilustrime me figura, vetëdija për ndikimet dhe efektet e sjelljeve të ndryshme mund të rritet.

Argumentet dhe përfitimet e heqjes dorë nga përdorimi i makinës ose përdorimi i saj në mënyrë eficiente për "Javën Evropiane të Lëvizjes" janë të njëjta si ato të viteve të mëparshme duke shtuar edhe disa të tjera: kursime në liché me qumimet e larta të karburanteve, pavarësi nga qumimi në rritje i karburanteve

ose nga mungesa e tyre në të ardhmen etj.

Siç u përmend më sipër, tema si e tillë është një gjë, por sloganit që do të përdoret është diçka tjetër. Është propozuar që mund të ishte i përshtatshëm një slogan që bën të qartë se gjithsecili mund të kontribuojë për uljen e emetimit, uljen e zhurmës dhe ndotjes së ajrit, për përmirësimin e cilësisë së jetës në qytetin e tij/saj etj.

Gjithsesi kjo ishte ideja qendrore e Javës Evropiane të Qarkullimit.

Mesazhi i sloganit është që gjithsecili kontribuon në mënyrën që ai/ajo mundet, në analogji me sloganin "Shumë grupe të vegjël njerëzish, në shumë vende të vogla, duke bërë shumë gjëra të vogla, janë duke transformuar botën".

Të gjitha aktivitetet që krijojnë një ndënjë reciprociteti, aksione të përbashkëta dhe përbashkëta të arritura kanë një shans të madh që të jenë të suksesshme.

E Çuditshme

Zogu që kushton 5000 EURO

Një grifshë e vetme mund të "mbjellë" deri në 3000 fara lisi në muaj

A e dini se zogu që quhet grifsha (*Garrulus glandarius*) është zogu më i rëndësishëm për mjelljen natyrore të pyjeve të lisave... dhe se përhapja e disa llojeve të lisave në natyrë muret plotësisht nga prania e këtij zogu?

Grifsha është një nga zogjtë më të përhapur në planetin tonë duke okupuar pyje nga më të ndryshmit, që nga tajga

kërkojnë të çiftohen. Në vjeshtë dhe në dimër, një numër i madh i lëndëve të lisave mbledhen në territoret e grifshave dhe fshihen në tokë



siberiane e deri te pyjet tropikal të shiut në Tailandë. Të ndrojtura dhe shumë të kujdesshme, ato janë tipike në klithmat e forta të alarmit që lëshojnë, që në sinjalin më të vogël që një prej tyre lëshon kur shoh mrezikun përmes penëve.

Në mars ato formojnë grupe deri në 30 grifsha. Grupet më të vogla përbëhen nga zogj femra të cilat ndillen nga grupe meshkujsh që

për t'i përdorur më vonë si ushqim. Grifshat i mbulojnë ato në grapa në tokë duke vepruar njësoj si një punonjës që mbjell panë. Është gjetur se një grifshë e vetme mund të "mbjellë" deri në 3000 lëndë (fara) lisi në një muaj. Nga llogaritja e kostos së „punës së tyre del se një grifshë realizon një punë të barabartë me 5000 EUR-o që i duhet një ndërmarrjeje pyjore për të realizuar këtë pyllëzim



Reportazh

Vlerave shqiptare promovohen nëpërmjet guidave natyrore

Mrekullia e një plazhi

Nga Indrit Kodra



Velipoja, rreth 33 km nga qyteti i Shkodrës, është një ndër zonat më të bukura të Shqipërisë ku gërshetohen natyrshëm tre nga tiparet më të bukura të natyrës: bregdeti, rezervati natyror dhe laguna e Vilunit. Secili nga këto komponentë ka të veçantën e tij duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për guidat natyrore si një risi në zhvillimin e ekoturizmit shqiptar.

Qendra "EDEN" dhe Milieu Kontakt International zyra në Tiranë në 5-8 tetor mundësuan në Velipojë trajnimin për Udhërrëfyesit e Natyrës (UN-të) të Qendrës "EDEN" me

pjesëmarrjen e trajnerëve të kësaj qendre Z.Ferdi Bego, Z.Genti Kromidha si dhe drejtori i politikave për zonat e mbrojtura në MMPAU, Z.Zamir Dedej. Gjatë trajnimit u dhanë njohuri të përgjithshme për historikun e zonave të mbrojtura në botë dhe Europë, informacion për politikën kryesore për zonat e mbrojtura



sipas IUCN. Disa nga çështjet kryesore me interes të veçantë për të pranishmit ishin:

- Legjislacioni shqiptar për zonat e mbrojtura
- Kategoritë e zonave të mbrojtura
- Administrimi i zonave të mbrojtura

- Komiteti i menaxhimit të zonave të mbrojtura

Çdo pyetje që lidhej me tematikën të ndryshme të zonave të mbrojtura u arrit të konkretizohet nga shpjegimet e specialistëve të mjedisit duke akumuluar informacion të vlefshëm për zonat e mbrojtura në Shqipëri.

Procesi i hartimit të planit të menaxhimit të një zone të mbrojtur dhe plani i punës për hartimin e tij ishte një nga dobjektivat kryesorë të trajnimit dhe ndikoj në përmirësimin e aftësive komunikuese të UN-ve për të qenë një guide natyrore e suksesshme.

Një tjetër aspekt i trajnimit ishte puna studimore në terren, ku ndarja në grupe kishte si qëllim: përcaktimin e vlerave dhe problematikën e zonës së lagunës së Vilunit dhe rezervatit natyror të Velipojës. Duke u mbështetur tek informacioni i dhënë nga trajnerët dhe puna në grup për secilën zonë u paraqit prezantimi me të gjithë elementët e saj.

Metodat e përdorura gjatë trajnimit përfshinë punën me harta, idetë krijese, Konkurrenca midis grupeve të punës krijoi lami idesh duke ndikuar pozitivisht tek udhërrëfyesit e natyrës pasi ata do të jenë drejtuesit kryesorë të këtyre guidave për të promovuar vlerat natyrore dhe turistike të këtyre zonave me rëndësi të

madhe për zhvillimin e turizmit vendas.

Vlerësimet e paraqitura gjatë trajnimit shprehën çartë suksesin e arritur nga organizatorët dhe vazhdimësinë e trajnimeve të tilla për të ngritur kapacitete për promovimin e vlerave shqiptare si për turistët vendas dhe për ata të huaj.



Foto - Lajm

Një loqë e ngordhur në plazhin e Velipojës e cila qëndron aty prej kohësh

Potenciale turistike nënujore gjatë guidës në Vlorë

Guida përfshin detaje mbi bregdetin e gjirit të Vlorës dhe atij të Karaburunit

Vlorë- Kohet e fundit shpota "Nënujzat" e mbështetur nga Projekti MEDWDCOAST, ka realizuar një guide të veçantë për zonën e Vlorës ku

përfshihet qyteti, Laguna e Nartës, ishulli i Sazanit, Karaburuni, Raku i Llogorasë dhe Laguna e Nartës.

Në këtë guide, për herë të parë janë

dhënë dhe potencialet turistike nënujore të bregdetit të gjirit të Vlorës dhe bregdetit shkëmbor të Karaburunit.

E veçanta e saj qëndron dhe në faktin

që hartimi i guidës është mbështetur mbi një pamje të madhe, tridimensionale të të gjithë kësaj zone brenda së cilës jepen me saktësi dhe në

një formë artistike, potencialet e shkurta dhe të shumëllojshme të kësaj zone për turizmin në fushën e natyrës, kulturës dhe historisë.





Shkurt nga bota

NDOTJA NË OQEANE-SHKAK I PAKËSIMIT TË KAFSHËVE

Ndotja në lumenj dhe oqeanë mund të jetë shkak për reduktimin e shumë popullata kafshësh. Mendohet se kjo po ndodh me popullatën e Belugave ose Balenës së Bardhë në detin e hapur të Sh. Lorençit në Kanada. Mendohet se në 1900 në këtë zonë jetonin më shumë se 5000 kafshë. Vlerësimet aktuale janë që popullata është pakësuar deri në 450 individë. Shkençtarët besojnë se mbetjet toksike të depozituara nga industritë e vendosura pranë lumenjve do të shkaktojnë ngordhjen e këtyre kafshëve. Ekzaminimi i kufomave tregon nivele të larta të produkteve të kimikateve helmuese si polikloratet, DDT, merkuri dhe kadmiumi.

RREZIKU PËR OBEZITETIN, KANCERNI, DIABETIN DHE ULJEN E FERTILITETIT

Kimikate në ushqimet që konsumohen në të gjithë Europën

Zvicër, Belgjikë: Që nga produktet e qumështit e deri tek mishit dhe peshku përmbajnë kimikate industriale Ky është përfundimi i një raporti të publikuar në 21 shtator nga WWF për ushqimet e konsumuara në Evropë.



Raporti i ri "Zinxhiri i kontaminimeve, hallka ushqimore", tregon se ushqimi është një

hallkë themelore në zinxhirin global të mbajtjes, që fillon me prodhimin e kimikateve dhe mbaron me shfaqjen e padëshirueshme të tyre në gjakun tonë, në një

rezik potencial për shkakimin e sëmundjeve të rrezikshme. I njëjti koktej kimikatesh të rrezikshme është evidentuar në jetën e egër dhe mjedis.

Duke qenë në krye të zinxhirit ushqimor, njeriu është veçanërisht i ekspozuar ndaj kimikateve në ushqime. Dista nga këto kimikate janë të ngjashme me hormonet, ato ndryshojnë në sistemin tonë endokrin dhe mund të jenë një faktor rrisht për sëmundje si obeziteti, forma të ndryshme kanceri, diabeti si dhe ulje të fertilitetit. Këtë vjeshtë parlamenti evropian do të votojë ligjin e ri të kimikateve (REACH), që është krijuar për të mbrojtur njerëzit dhe botën e egër nga këto lëndë të rrezikshme e rrezikshme të prodhuara nga njeriu.

Raporti i WWF tregon rezultatet e analizave të nxjerra nga 27 mostra ushqimesh të ndryshme të blera në supermarketet e tre vendeve të BE-së: Angli, Itali, Spanjë, Greqi, Suedi, Finlandë dhe Poloni. Produktet e testuar përfaqësojnë produkte të qumështit, mishit, peshkut, drithërave, mjaltit dhe vajit të ullirit. Mostrat u testuan për tetë grupe të ndryshme kimikatesh të prodhuara nga njeriu.

Nënkohë që WWF thekson se njerëzit jo domosdoshmërisht sëmurën nga konsumimi i këtyre ushqimeve, organizata botërore është shumë e shqetësuar mbi efektin e mundshëm afatgjatë të niveleve të ulëta ekspozimit të kimikateve në dietë, sidomos në zhvillimin e fetusit, foshnjave dhe fëmijëve.

Ushqimi është një nga rrugët më të rëndësishme të ekspozimit të njeriut ndaj mbetjeve, veçanërisht atyre që grumbullohen në mjedis, si DDT, PCB dhe fiksisit e kumuar të zjarrit. Por kimikatet hyjnë në mjedis në shumë mënyra të tjera: rrjedhjet gjatë prodhimit transportit ose ngritjes së tyre, përdorimit direkt dhe indirekt në produkte si kompjuter dhe televizorë.

R. Tashi

GRUPIMI "EKOLËVIZJA"

- Shoqata e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit Natyror, Shkodër - Fatbardh Sokoli
- Shoqata e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit Natyror, Tiranë - Pranvera Bekteshi
- Shoqata Kombëtare progresi pyjor - Tiranë, Liljana Shehu
- Albalforest, Tiranë, Mehmet Meta
- Qendra Eden, Tiranë - Merita Mansaku
- Klubi Ekologjik, Krujë - Muharrem Goci
- Shoqata e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit Natyror, Berat - Genta Decolli
- Liliun Albanicum, Librazhd - Ferit Hysa
- Masmedia dhe Mjedisit - Xhemal Mato
- Qendra për Komunikimin Elektronik, Tiranë - Ladi Balla
- Qendra Kombëtare e Lëvizjes Ambientaliste, Tiranë - Hëviz Marku
- Klubi Ekologjik, Elbasan - Ahmet Mehmeti
- Instituti i Studimeve të Ambientit, Tiranë - Agron Deliu

- Laguna e Kaltër, Orikum - Skënder Mejdaj
- Klubi Ekologjik, Librazhd - Naim Disani
- Shoqata Pylli i Blertë - Buçinas, Rogozec - Ruzhii Hymetllari
- Milieucontact Cost Europa, Tiranë - Vallbona Mazreku
- Shoqata e Përmkulturës, Tiranë - Rllira Milla
- Klubi Ekologjik, Tiranë - Fatos Xhemalaj
- G&G Group, Tiranë - Sazan Guri
- AULEDA, Vlorë - Hasan Hallko
- Shoqata Mjedisit Ekologjik dhe Turistik Lura, Lurë - Ismail Hysa
- Federata e gjetarëve sportivë të Shqipërisë, Tiranë - Them Perri
- Qendra e konsulentëve veterinarë dhe sigurisë ushqimore, Tiranë - Gani Moka
- Klubi Ekologjik, Maliq - Myzafer Gjiriti
- Shoqata "Natyza për njeriun", Durës - Pali Ndreka

R. Tashi

Shkurt nga bota

TRE VJET I VETËM NË SHPELLË

Romë-Maurizio Montalbini, sociologu dhe speleologu i famshëm italian, i cili ka nëntë rekorde në qëndrimin në shpellë (gjithsejtë 366 ditë pa ndërrerje), ka vendosur që ta përsërisë



eksperimentin e tij, por këtë herë ai do të qëndrojë në shpellë më tri vjet. Ai këtë javë është lëshuar në një shpellë, në pjesën qendrore të Italisë, duke marrë me vete ushqim në pilula, katër kilogramë mjalte, arra etj. Shkençtari do të qëndrojë në shpellë, në një thellësi prej 80 metrash, gjerësi prej dy metrash dhe gjatësi prej pesëdhjetë metrash. Montalbini është drejtor i ekipit hulumtues që merret me studimin e kufijve psikofizikë të njeriut. Qëllimi i eksperimentit të tij është që të njihet në mirë ritmi natyror i trupit, për të dhënë doza efikase të medikamenteve, në luftën kundër stresit dhe pagjumësisë.

A.L

ZBULOHEN SPECIE TË REJA ORKIDESH NË GUINENË E RE

Një nga tetë specieve të orkideve të zbuluara (Cadetia Kutubu)

Zvicër: Një seri ekspeditash nga shkençtarët e WWF në zonat e paeksploruara të pyjeve tropikale të Papuas në Guinenë e Re kanë zbuluar specie të reja orkidesh të pazbuluara më parë nga shkenca.

Pas serisë së ekspeditave në rajonin e Kikorit (Guine e Re) nga 1998-2006, ekipi i WWF mbledhi rreth 300 specie orkidesh. Tetë prej tyre u konfirmuan si specie të reja, mësa 20 të tjera ende pritet të verifikohen.

Papua ka më shumë specie orkidesh se çdo shtet tjetër në botë.

Njoftimi për këtë zbulim vjen vetëm një javë përpara njoftimit zyrtar të dy zonave të reja të menxhimit të jetës së egër, që do të mbrojnë zona të konsiderueshme të pyjeve tropikale, ku edhe u gjetën këto orkide.



Kuriozitete nga mjedisi

• Drita e xivëllonjës nuk të djeg, duke qenë se është drita në e ftohtë në botë. Ja pse, ajo shpërndan një sasi të papërfillshme energjie për ngrohje.

Kapaciteti i një organizmi për të prodhuar dritë quhet lumineshenë. Xivëllonja mëshkull lëshon sinjale ndriqes për të tërhequr femrën.

Megjithatë, femrat e disa specie xivëllonjash gjithashtu lëshojnë sinjale të këtij lloji për të tërhequr prarë me të cilën do të ushqehen.

• Vlerëschet që në planet ekzistojnë 4600 specie gjitarësh, 31 000 specie peshqish dhe më shumë se 900 000 specie insektesh, shumë prej të cilëve janë ende të paidentifikuar.

• Çdo vit shkatërrohen më shumë se 13 milion hektarë pyjesh tropikale. Nëse do të llogaritej kjo do të përfaqësonte 35 000 hektarë në ditë, 1500 ha në orë ose 25 ha në minutë.

• Sistaret e lumit të Amazonës kanë diversitetin më të madh të peshqve në botë. Janë cilësuar më shumë se 1500 specie, por supozohet se ekziston të paktën dyfishi i këtij numri. Kjo është pesëmbëdhjetë herë më shumë se numri i atyre që gjenden në lumenjtë evropianë.

• Në 25 vjet peshkagani gri mund të prodhojë mbi 20 000 dhëmbë, gjë që shpjegon edhe pse dhëmbët e peshkaganeve janë një suvenir i parapëlqyer.

• Flutura Viceroy është shumë e shijshme për grabitqarët, por ajo për të shmangur grabitqarët ngjyroset në mënyrë shumë të ngjashme me fluturën Monarch, e cila ka shije shumë të hidhur, kështu grabitqarët e lënë të qetë.

• Dihën 1000 bletë që të punojnë gjithë jetën e tyre për të prodhuar 1/2 kg mjalte.

• Titanus Gigantus është brunbulli më i madh në botë dhe ka një gjatësi më të madhe se 20 cm. Ai është më i madh se dora e njeriut.

Botimi i "Ekolëvizjes" mbështetet nga fondacioni "Princ Bernhard Cultuurfonds"



Njoftim

Të dashur lexues e bashkëpunëtorë, Nisur nga strategjia jonë për të kaluar në një shërbim informues të qëndrueshëm për mjedisin, në bazë të orientimit të bordit të grupimit të shoqatave mjedisore "Ekolëvizja", redaksia ju fton për t'u pajtuar në gazetën "Ekolëvizja".

Pagësa e pajtimit për një vit kalendarik, me dy numra në çdo muaj, është vetëm 1000 (një mijë) lekë.

Përlllogaritja e kohës së pajtimit bëhet menjëherë pas derdhjes së shumës së caktuar në Bankën Amerikane me numër llogarie 1042531801/0203 (euro, dollarë, lek) dhe fillimit të marrjes së gazetës.

Nëse jeni i interesuar të vazhdoni të merri gazetën "Ekolëvizja", drejtohuni në redaksinë tonë për pagësen dhe për proklam të tjera me interes të përbashkët.

Adresa: rruga "Avdyll Frashëri", ish-klinika e udhëheqjes, shkalla 3, qka. 4, Tiranë. Tel. 04 234 851; Cel. 068 21 82 081; e-mail: ekolevizja@yahoo.com Redaksia e gazetës "Ekolëvizja"

STAFI

EDITORI - Xhemal MATO
Kryeredaktor - Rezart LAHI
REDAKTORE
Rovena TASHI
Indrit KODRA

Adresa e redaksisë: Ish- klinika qeveritare, shkalla 3, kati IV, Tiranë
Tel.: 04 234 851, Cel.: 068 21 82081 e-mail: ekolevizja@yahoo.com

TIRAZHI: 600 KOPJE